



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 5, datë 26.01.2023

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESAT E TRANSPARENCËS NË LIDHJE
ME INFORMACIONIN E SHOQËRIVE TË LISTUARA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 7, pika 2, germa gj, nenit 295, pika 3, nenit 300 dhe nenit 301 të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020, “Për Tregjet e Kapitalit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e Rregullores “Për kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin e shoqërive të listuara”, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Titujve për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**